

MAKU PONE

GJ

*Kur  
buzëqeshin  
shokët*

VJËRSHA

PSH-1

P85

MAKU PONE

PSH-1

S

# KUR BUZËQESHIN SHOKËT

*Vjersha*

~~40277~~

14/67

LIBRERIA E SHITJEVE  
GJERËNARIT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## MOSHATARËVE

Nënat na rritën me qumësht,  
Fushat na rritën me erë,  
Rrugët na lyen me baltë, —  
E ardhmja trokiste në derë.

Gjyshet na tundën në djepe,  
Etërit me pushkë na rritën,  
Arat me gorgat e ashpra  
Grurin të mbillnim na pritën.

Të fortë krahët i kishim,  
Fushat me kosë i brodhëm.  
Dimrat e egër s'na mbrapsën,  
Verat e nxehta s'na lodhën.

Të qeshnim bukur ne dinim,  
Me rrënjë malet i tundnim!  
Një këngë e fuqishme ishim,  
Këngë baroti dhe plumbash.



## KËNGA IME

Është e hershme kënga ime, shokë  
Si janë të hershëm barërat, drurët, ugaret.  
Kënga ime ka mbirë përmbi tokë  
Në lashtësi me arat.

Kënga ka përjetësinë e fushave  
Fëshfërima gjethesh, kënga ka;  
Në të madhështinë e egër të maleve  
Të thjeshtë, e gjen si malet —  
në një varg.

Kënga ka gëzimet e pamatë të popullit,  
Buzëqeshjen e lumtur të ngadhnjimeve të  
mëdha,  
Vringëllimën e shpatave  
dhe erën e barotit  
Kjo këngë e popullit ka.

• Është e hershme kënga ime, shokë,  
Ndonëse atë tani e nis,  
Ajo me popullin shekujve ka qenë tok,  
Unë vetëm sa e përsëris.

## E DI UNË

E di unë, drurët dinë të flasin:

Pëshpërisin

kur era fryn e lehtë;

M'i moçmi dru i thotë më të riut

Si të qëndrojë, kur bën stuhi e rreptë?

Dhe ç'fjalë dëgjoj prej drurëve në shtërngatë!

M'i moçmi thotë:

«Qëndro i denjë, bir!»

Dhe qëndron njomëzaku i pamposhtur

dora-dorës me shokët kapur,

Dhjetëfish i fortë,

I përtërirë.

## SHTYLLAT ELEKTRIKE

Ecën këto shtylla në një rradhë të pafund,  
Ngjiten  
Dhe ngjiten pa u lodhur kurrë.  
Dua t'u ngjaj: të ec e të ngjitem çdo ditë, që të mund  
Mendime të qarta t'u çoj njerëzve  
Si këto shtyllat —  
dritë!



## KUFITARI NATËN E VITIT TË RI

Nuk ndjej ndonjë mall për pemën e vitit të Ri...  
Këto pisha vigane  
Me dëborë ngarkuar  
Edhe më bukur më ngjajnë, se pema në shtëpi.

Vetëm për ju kam mall, të dashurit e mi.  
Po ju jeni larg  
Dhe unë këtu ndodhem, në detyrë.  
Mesnatë...  
Ju shoh si po çikni gotat  
Dhe për mua thoni që të gjithë:  
«Këtu sikur të ish!...»

Po ju aty më keni.  
Zgjatmáni dorën; e shtrënguat? Më fort, më fort.  
E ndjej unë gëzimin tuaj;  
Tani më i fuqishëm,  
Më i lumturi në botë.



## VARGJE PËR MIQËSINË PUNËTORE

Ti nuk munde dot një sy t'u hidhje  
Vargjeve të mia, s'pate kohë.  
Nuk ka gjë, i dashur. Ti e dije, —  
Shoku priste ndërrimin në të ftohtë.

Bora binte, era krejt të thante,  
Ti guximshëm çaje nëpër shqotë.  
Unë, për ty po shkruaja këto vargje,  
Ndërsa digjeshin drutë në sobë.

S'pate kohë të thoshje: «Varg i ngrohtë,  
Varg për miqësinë punëtore»,  
Por ecje, ecje në të ftohtë,  
Supeve të binin flutura bore.

Veçse ndjeje vargun që do shkruhej,  
Ndaj dhe hapat hidhje me vërtik, —  
Shoku priste ndërrimin, ti e dije,  
Menca mund të mbyllej në konvikt.

Ti në rrugë nxitoje i dërsirë,  
Xhupin të mbërthyer kënd e kënd,  
Kërkëllinte ujët që kish ngrirë, —  
Shoku që larg ndjente hapin tënd.

## NAFTËTARËT NË DHOMËN E NGROHJES PAS PUNËS

E zakonshme kjo dhomë, dërrasat të vjetra.  
Edhe fryn pak erë nga ndonjë e çarë.  
Po këtu mblidhen naftëtarët në mbrëmje  
Rreth zjarrit,  
Si një familje e madhe e pandarë.

Gjithshka, e përbashkët është këtu, në mes  
punëtorëve:

Kjo tokë, e mbrujtur tërë naftë,  
E mbrujtur tërë këngë,  
Tërë jetë,  
Tërë dritë;  
Në fytyrën e shëndetshme të secilit  
Mendimi për të nesërmen — komunizmin  
Shëndrit.





## KËNGË PËR SHOKËT E MI NAFTËTARË

Atë e trembi rrugë e largët,  
Ai u fsheh prej nesh,  
S'duronte erë përmbi supe,  
As shi mbi kokë s'desh.

Nuk desh të shkelte nëpër shkrepë,  
Të bëhej me ne shok,  
Nuk desh të dinte për të fshehtat  
Që thellë ruan kjo tokë.

Na pa një mbrëmje në barakë  
Kur qeshnim tërë humor,  
Po duket, u hutua pakë  
Nga zëri punëtor,

E pamë të strukej në një qoshe  
Tek heshtte fytyrënxirë,  
Nga zërat basë buçimplote  
S'e ndjente veten mirë.

Na pa të veshur thjesht —  
dhe iku,

I thanë se s'mbajmë kravata,  
Se dhe këpucët kur i blejmë,  
S'i duam me majë të gjata.

I thanë: Netëve të dimrit  
Me shkop do ta rrahë era,  
Se s'njohin naftëtarët luksin  
As modë,  
etj. etjera...

Se ca të vrazhdë janë në jetë,  
Nga që jetojnë larg,  
Se deri sot asnjë poet  
Për ta s'ka thënë një varg.

Se me ciganët shëmbëllejnë  
Që enden strehë më strehë,  
Dikush i tha kështu...

Ai

Iku, larg nesh u fsheh.

Nuk donte baltë nëpër këmbë,  
As pluhur nëpër flokë,  
Me ne të futej në çdo këngë,  
Të bëhej me ne shok.



Të shihte yjet s'desh  
si digjen

Në gusht,  
Në turn të tretë,  
Si nga lëmenjtë që u shinë  
Vjen era bereqet.

Se si në mbrëmje përqark radios  
Atdheun ne dëgjojmë  
Dhe shohim pranë: rrugët, qytetet  
Shtëpitë si ndërtojnë.

Si këngët plot buçime tunxhi  
Shpërthejnë përreth nesh,  
Me mijëra buzëqeshje atdheu  
Kantierin tonë e vesh.

Megjithatë në trotuar  
Të veshur, ngjeshur shik  
Atë e shohim —  
një qyqar  
Q'u vodh nga ne tërë frikë.

Që ca të vrazhdë i thanë se jemi,  
Se rreptë na rreh era,  
Se s'njohim luksin, modën, vargjet  
Dhe shumë e shumë të tjera.

Frikac i ngratë,  
I ri — i plakur,  
Me grusht-varrë dërmojmë  
Ne botën tënde varfanjake, —  
Na sheh vallë si marshojmë?

Dëgjon si hapi ynë buçet  
Në ballë të pesëvjeçarëve,  
Sa larg na shpje, sigurtë na shpje  
Kjo këngë e naftëtarëve!

**MIKROBORGJEZIT**

I cektë —

si një lerë në rrugë.

Merr lugën,

ha:

Kuzhina

ç'të duash ka.

Në guaskë të vet

Rritur,

Në vogëlsira të mykura

zhytur.

Më larg se hunda s'sheh, —

Të hashë,

të pishë

ke!

Punon babai

dhe gruaja...

Mikroborgjez i ngratë!

Ti, ndoshta dhe nga fëmija

Po pret

ndonjë kafshatë.

~~49247~~  
14167

LIUTERA E SHIEMA  
GJROMASTEP



Posi,  
me lugë të vockël  
Të të kojë  
tek rri i qetë,  
Si lerë e pistë në rrugë;  
I cektë,  
fare i cektë.  
Me syze dielli jetën  
Nga qoshku yt  
vështron,  
Të shohim —  
dhe çuditemi:  
Hej, rron ky apo s'rron?  
Ç'je ti —  
një bar i thatë  
Që shkelesh  
nëpër këmbë;  
Do të gozhdoj, me theksat  
E mprehtë  
të kësaj kënge!  
Në cakun tënd të ngrohtë  
Të qetë  
nuk do të lëmë,  
Plotësisht do të dërmojmë  
Me vargun tonë —  
gjëmë!

## KONTROLL PUNËTOR

Erdhi kontrolli punëtor,  
I rrepti kontroll punëtor,  
Erdhi thjesht;  
As muret s'u tundën në korridor,  
As drurët s'u drodhën...

Po prap, ka kush dridhet,  
Ka kush fshihet si minjtë në vrimë  
Dhe pret me ankth me shpatë t'i bien kokës:  
Burokrati, që mes shkresash propozimin harroi  
Dhe për gjashtë muaj e la  
Pluhur i harrimit ta mbulojë.

Dridhet ndërgjegjja e vogël e shpërdoruesit,  
Që pa kokëçarje  
Si ujë të panevojshëm përtokë derdhi benzinë.  
Ecën thjeshtë kontrolli punëtor, pa zhurmë,  
Po drejtësi e tij të pret,  
Të ngrin.

## VERTETËSIA

Nuk është kaq e lehtë: erdhe me një çantë të madhe,  
të fryrë,

Shkunde pluhurin

Dhe në një stol u ule me punëtorin si shok,

Diku në një zyrë.

More lapsin,

Dhe ç'të thanë —

shënove në blok

Dhe pikë.

Asgjë më shumë

Ca shkronja shkruar shpejt, kuturu

Dhe zhurma e kantierit që ndihej larg, diku...

Dhe mund të ikësh

Me ca copëza jete të zhvatura, cunuar,

Me fiksiione të zbeta që u merren këmbët

Dhe s'ngopen me frymë

Në atë çantë barklëshuar.

E do rrjedhin të nesërmen fjalët lumë në gazetë,  
 Do rrjedhin aq sa çanta mund të mbushësh me mija,  
 Vetëm, mes rreshtave të zbrastë, të shkretë  
 Do mbledhë buzët vërtetësia.

MARSHIMI I REVOLUCIONIT

Tymosin punokretët në zyrën e rrethit  
 Shtruan përhapur në tërësi në fushë  
 Llojtë e mblodhjeve, në shokull i plotë  
 U rrjedhën shprehjet në formë të gjuhës  
 Rrethim mendimet e mësuesit si rrethim  
 E pamundur bëhët shprehjet e detyrës  
 Kështu thosë kokat nga tyri të hapura  
 Në rritje të marta

Në çast detyrës shprehjet fort  
 Askush e përjetët - hyri -  
 Mërkata, vullshëm hyrë ditët punës  
 Fytyrat e punës, tërësisht në tyrim  
 E përhapim detyrës, thosë të ditët, - do të çojmë  
 në fund  
 Dhe do të shprehjet në tërësi rrethim -  
 Hështim punës  
 Mërkata e shprehjet e tyri kërkues



## MARSHIMI I REVOLUCIONIT

Tymosin burokratët në zyrën e ngrohtë.  
Shkresat, përhapur si kërpudhat në fushë.  
Dhjetë orë mbledhje, një shekull i plotë,  
U rrjedh djersa në faqe, në gushë.  
Rahim mendimet e mykura si rekat e hedhura:  
«E pamundur është tejkalimi i detyrave».  
Kështu thonë kokat, nga tymi të dehura,  
Nga rutina të mpira.

Në çast dera troket shumë, fort,  
Askush s'përgjigjet «hyni».  
Megjithatë, vrullshëm hyjnë dhjetë punëtorë.  
Fytyrat e burokratëve, mbështjellë nga tymi.  
«I peshuam detyrat», thonë të dhjetë, «do t'i çojmë  
në fund  
Dhe do, t'i tejkalojmë, asgjë e jashtëzakonshme».  
Heshtin burokratët,  
Mendimet u lëkunden si dallgët e tymit kaltërosh.

Kaq. Hapet dera, dalin që të dhjetë,  
Mbetet zyra e heshtur, e shkretë.  
Jashtë, dhjetë marshojnë në revolucion,  
Në zyrë tymi rrallon, rrallon...

MUSHTI TËAR

Nuk e çorri gjumi mjetshin plak  
Dyshim për vete, sikur t'kthehë e priste.  
Dëgjonte zhanë motorash që iate  
Kjo zhanë në timpan të veshti i buaste.

Ish dita e parë në parison  
Tani duhet të endsonit gjithënjë.  
Të flinte i parë në shtetin e ngrohtë  
Të trinte në parë rishitjeve të qata  
Të trinte në parë ditët të marta të rëndonte  
Pa data.

Të shitejonte raxhën strukur në shuifë  
Të jetonte me koren e hieshure.  
Jo rjeshind hite joi i thoshte një të --  
Të korrë mund të jesh i rrethshëm!

## MJESHTRI PLAK

Nuk e zuri gjumi mjeshtrin plak.  
Dysheku nën vete, sikur t'ishte thikë e priste.  
Dëgjonte zhurmë motorash që larg,  
Kjo zhurmë në timpan të veshit i buçiste.

Ish dita e parë në pension.  
Tani duhej të çmësonte gjithshka,  
Të flinte i qetë në shtratin e ngrrohtë,  
Të rrinte në park mbrëmjeve të gjata,  
Të rridhnin të mpira ditët, të mugta, të rëndomta,  
Pa data.

Të shfletonte gazetën strukur në shullë,  
Të jetonte me kohën e hershme.  
Jo, njëqind herë jo! i thoshte një zë, —  
Ti kurrë s'mund të jesh i ngeshëm!

Nuk mund të rrotullosh të shkuarën si tespi,  
Të rrosh me gëzimet e kaluara,  
Jo, njëqind herë jo, mjeshtër mos fli,  
Ngreu!  
Trokasin zhurmat e papushuara.



## FLAKJA E IKONËS NË OBORRIN E VJETËR

U mblodhën të rinjtë në oborrin vjetër,  
Në duar mbanin një ikonë të lashtë.  
Ikona heshtte;  
Sytë e saj të vdekur  
Asgjë nuk shihnin rretheqark.

Në gaz të plotë  
Gjithë zhurmë e bujë  
Kalldrëmin e lagjes shkelnin këtë radhë,  
Godiste çapi tyre rëndë,  
Ndërsa një kënge fort ja kishin marrë.

Ikones i kishin mbetur dit' e fundit, —  
Të rinjtë vendosën:  
Në gropë të plehrave tej ta hidhnin  
Këtë kalbësirë  
Që ndotte dikur pragjet,  
Që plakat tona aqë mirë e njihnin.

Dhe ja, ku shohin plakat, që nga portat  
Mezi të hapura përgjysmë:  
«Pupu, të zeza, ç'po përmbysët bota!»  
Fjalosin ndrojtur  
Me zë të mbytur.

Eh, ju, që ikonave u keni rënë në gjunjë,  
Kur tallej zër' i priftërve në shekuj:  
«Robër, që po vuani,  
Në botën tjetër s'keni për të hequr...»  
Ç'na shihni ndrojtur?  
Buzëqeshni  
Dhe vallen tonë ejani ta hiqni!

Një jetë të tërë fytyrëverdhe  
E shën-Mërisë, trishtim u ngjalli,  
Gjithshka të bukur që u ruante shpirti  
Cinizmi i saj e talli.

Hej, ti gjyshe, që fort ikonën ruajte  
Se ndjen ç'erë myk të kundërmon  
shtëpia?

Përjashtë flake  
Dhe mjaft ndër buzët truejte,  
Në gazn' e saj po të fton rinia.

Se si të vjen? E ke të zorshme?  
Pa eja, bashkë ta flakim përgjithmonë,  
Do shohësh, gjyshe, si do ndrij shtëpia...  
Me ne shpejto, në gazin tonë!

Përçark në valle të rinjtë u mbështollën,  
Përçark një këngë të gëzuarshme morën,  
Vështronin gjyshet  
Vështronin nënat.

Në oborrn' e vjetër të mëhallës  
Në gropë ra ikonë e lashtë,  
Me të mbaroi një botë e kalbur...

Po digjej vallja rretheqark!



## LAJMËSIT

I kërrusur  
si një pikëpyetje e madhe,  
Me shkop në dorë  
ti hape aq dýer,  
Ti hape aq plagë  
dhe jetë të tëra mbylle.  
Njeri i prapë,  
që kurrë s'ke qenë njeri,  
Ç'u bëre vallë,  
ç'je vallë tani?  
Një shkop i ndotur  
që u bëre shkrumb në zjarr.  
Goditja jonë  
në kokë të ka marrë!



## UNË ECI

Unë eci mbi këto lartësi vigane,  
Ku ujërat e kaltëra vërshojnë teposhtë,  
Ku copëra dritash përthyhen  
e bien

Mbi supet e mij,  
Mbi ballë e mbi flokë.

Nga një e çarë resh, e gjerë si dritare,  
Më shfaqet në mjegull  
Kantieri në fushë  
Dhe akoma më tej të lashtat e mbara.

Hej, sa e lehtë kjo çantë me kampione!  
Sa vrullshëm shpërthen mendimi krahlehtë:  
«Ja, do ngjiten rrugët e reja në male,  
Do ngrihen  
të tjerë kapanone  
Dhe zhurma e sondës do çajë në qiej».

Unë eci dhe eci  
E për një çast ja, më duket  
Se me këto duar të hekurta shtyj retë,  
Shtyj mjegullën  
Që dhe më shumë të qartësohen këto lartësi.  
Dhe, si shtëpi të lagjes së ardhme të ngjajnë  
Në mal,  
në qytetin e ri.

## PARTIZANI

Ne e njohim tani,  
Ne dimë lapidarin e tij.  
Nuk ja dimë emrin, por dimë më të vërtetin emër-  
të tij —

Ai është hero i luftës për liri.

Asgjë nuk na la:  
As lapsin, me të cilin do të ketë shkrojtur letrën e  
fundit,

Nuk e dimë atë letër ku e ka,  
Kush e mori dhe revoltën ndjeu të buçasë si furtunë.  
Me revoltë u mbushën nënat,  
Me revoltë u mbush Shqipëria,  
Duhej marrë gjaku i lirisë dhe i heronjëve.  
Lirinë dhe heronjtë i priste pavdekësia.

Asgjë nuk na la:  
Si i kishte vallë flokët, gështenjë apo të zinj?



Po sytë, kafe apo të kaltër?  
Buzëqeshjen si e kish?  
Të gjitha këto i dimë:  
Flokët — të përshkënditur nga flaka e barotit,  
Sytë — të zjarrtë-pishë, sy revolucionari,  
Buzëqeshjen — të gjerë e të pafund si ara me grurë,  
Të lehtë, të ndritshme e kish, si kallëzat e pjekur.

Asgjë nuk na la:

Si e kishte vallë zërin, bas apo të hollë?  
Po, sigurisht, ne e dimë tingullin e zërit të tij,  
Ja, tani e dëgjojmë si ushton mes gjëmimeve,  
Në zjarrn' e luftës çlirimtare  
Kumbon zëri i tij: «Shokë, përpara»,  
Zëri i tij gjithmonë thotë: «përpara».

Asgjë nuk dimë:

Ku u vra? Kur e pushkatuan?  
Ish mbrëmje e vonë me re dhe shi,  
Apo në agim të bardhë e qëlluan?  
Kushedi, ndoshta pas shpinës e qëlluan tradhëtarët,  
Që si zagarë bridhnin pas hijes së tij.  
Po sidoqoftë, ne e dimë mirë:  
Ai atë çast lirinë ëndërronte,  
Ai e dinte, se jo drejt vdekjes  
Po drejt pavdekësisë shkonte.



Ne, midis jetës dhe vdekjes së tij lindëm,  
Midis vdekjes dhe pavdekësisë së tij.  
Ai është kudo:  
Ai është komunizmi.  
Të thjeshtë e ka emrin,  
Ne e njohim tani,  
Ne emrin s'ja dimë, por dimë më të vërtetin emër  
të tij —  
Ai është hero i luftës për liri.

### FLAKËT NDEZËN NATËN...

Tek ky mur i vjetër u përplasën krismat,  
Flakët ndezën natën  
Dhe verbuan yjet.  
Si të çmendur qeshën nëpër terr ballistat  
Dhe humbën në pyjet.

Po nga pas i ndiqnin krisma, krisma, krisma,  
Nata gjithë po digjej;  
Nata bëhej shkrumb,  
Nëpër drurë bridhnin, po u mbahej fryma, —  
Zëri i të vrarit  
Tokën po e tund.

Tek muri i vjetër mbeti një fëmijë.  
Si trumbë zogjsh të bardhë  
Traktet përmbi të,  
Porsi drurët dridhen nga tmerri ballistat,  
Se i ndjek nga prapa  
Një i rreptë zë:

«Në çdo hap që hidhni  
Pret kos'e urrejtjes:  
Do t'ju shpartallojmë,  
do t'ju shpartallojmë!  
— Luftë armikut t'egër! malet po thërrasin,  
Pyjet po godasin,  
Armët gjithë po zbrazen,  
Ne do të fitojmë!  
Ju vratë vetëm një,  
Vetëm një unë isha,  
Ndërsa traktet janë një popull i tërë!»



## POEZIA

Poezia nuk është vetëm rima të zgjedhura,  
Ritme që godasin në të tretën apo në të shtatën  
rrokje,

Nuk janë figurat tekanjoze të përhedhura  
Që të sigurta në poema zënë qoshet.

Jo shokë, poezi është dhe gjallëri e sallës  
Kur për një shpikje ende të paqartë flet e flet,  
O, si godet ritmi i saj i gjallë  
Pa pyetur për theksin e shtatë apo të tretë.

Si shkëlqejnë sytë e shkathtë të punëtorëve,  
Para tyre, çdo figure abstrakte do t'i merreshin  
këmbët,

Do të ndjente zagushi aty,  
Nga zori,  
Nuk do ta gjente rrugën për tek këngët.

\* \* \*

Thirmë, do të të vij, i lehtë si zog.

Të të thërres

e di se do të vish.

Kështu e thjeshtë, fillon

dhe ecën dashuria jonë.

Unë të pres

si toka pret pranverën

Që të hedhë bisqe

dhe lule të çelë prapë.

Pa thirrjen tënde

Si në tokë të shkretë

Rreth meje barërat kokën do të ngrinin

Dhe do të thaheshin prapë.

Bashkë më pjellorë jemi,

Më njerëzorë jemi.

Dy thirrje —

dy jetë,

Që fillimin bashkë e kanë

Dhe bashkë do ecin përjetë.

## V A R G J E T

Vargjet janë si pemët:  
Ca mbushen gjithë lëng, gjithë jetë —  
Dhe piqen,  
Ca mbeten të zbrazët nga brenda,  
Rrëzohen  
Dhe dergjen.

Mbeten të fortët, që mbartin të plotë  
Jetën e gjerë të popullit,  
Që s'kërkojnë të bredhin bibliotekave të botës,  
Që të provohen prej shekullit.

Vargjet' e shëndoshë futen shpejt në radhë  
Si shpikja e mënçme e punëtorit,  
që shpërthen e fuqishme.  
Shokë, le të ecim të sigurtë si vargjet,  
Që mbartin meditimet e kohës së stuhishme!

## NJE IMITONJESI

Të shoh si hiqesh zvarrë në gjurmat e të tjerëve,  
Në udhën tënde s'mbin as bar,  
As lule,  
As fletë.  
Aq e vockël është bota jote,  
Aq e zbrazët,  
E ngushtë,  
E cektë  
Sa ty të merren këmbët dhe hyn në dyert e të  
tjerëve.



## VJESHTA E ARTË

Kërcet shiu nëpër rrugë,  
Këndon shiu mbi çati  
Qielli është tani i mugtë,  
Vjeshta vjen me hap të ri.

Fletët bijen mbi oborre,  
Si fëmijë vrapojnë në udhë.  
Rrushin gjithë nga vreshtat mblodhëm,  
Jonxhën korrëm tej në fushë.

Vjeshtë, vjeshtë, nëpër gjethe  
Çapat hedh lirika ime  
Dhe, nga grur' i porsa hedhur,  
Mbijnë të artat frymëzime.

Fushat mbushur plot me mollë,  
Zverdh hurmá e pjekur shumë;  
Pambukun në arë mblodhëm,  
Varg të ri në këngët vumë.

## POEZIA E DE RADES

Poezia e tij —  
një fllad që fryn nga malet,  
Një fllad që fryn nga kopshtet,  
Ku qershitë për tokë rrëzojnë petalet.

Poezia e tij —  
ujëra përrenjsh malorë,  
që, në një të vetëm shkrihen  
Në shtrat të fuqishëm, madhështor.

Poezia e tij  
shkuma e bardhë-e bardhë e dallgëve,  
që, si një fluturim i pambarim ngjan  
I pulëbardhave.

Poezia e tij —  
vringëllima e armëve shqipëtare për liri,  
Dëshira për fitore  
Si më e fuqishmja dëshirë  
E një populli.

Poezia e tij

me rrënjët në popull zgjatur,

Poezia e tij,

që frymë mori nga gjoksi i kombit

Dhe pavdekësinë e popullit trashëgoi.

## ZEMRA E LIRIKUT

Zemra e lirikut e ndjeshme është, shokë,  
Si fija e barit,  
Si tel i kitarës.

Sytë e lirikut largpamës janë, shokë,  
Si sytë e partisë,  
Që mes shqotash shohin  
Të ardhmen.

Shpirt' i lirikut i gjerë është, shokë,  
Si fusha me grurë,  
Si fusha me thekër,  
Sa dhjetra dete e liqenj tok.

Dorë e lirikut e ngrohtë është, shokë,  
Si dora e gjyshes,  
Si dora e nënës.



Prekjani shpirtin —

Dhe do shihni

si prej tij

Qindra dashuri do të shpërthejnë!

Prekjani zëmrën

Dhe do shihni

Si di ajo të dashurojë dhe të urrejë.

Prekjani dorën

dhe do shihni

Si di ajo duart e shokëve t'i shtrëngojë,

Fuqimisht t'i shtrëngojë,

Si di ajo

Si shpatë e papërmbajtshme

Mbi armiqtë të qëllojë,

të qëllojë!

## PRITJA

U spërkata në rrugë me baltë:  
Ecja  
Nxitimthi.  
Natë.

Qe thyer llampa mbi shtyllë,  
Mushamaja pikonte.  
Llucë.  
S'e ndjeja të ftohtin,  
As ujin e pistë në këpucë.

E dija:  
Më prisje e shtrenjtë,  
Me thjeshtësinë e gruas që do.  
Baltën nga rrobot do fshije,  
Fytyrës time të lumtur gishtrinjtë do kaloje.  
Zëri i ëmbël — i ëmbël i yti do thoshte:  
«U lodhe?»

Dhe lodhja do tretej si vështrimet tona.

## TË DUA

Shiu —  
dhe ai do pushojë patjetër.  
Era —  
do lodhet dhe do të heshtë.  
Po unë —  
eci dhe eci  
Dhe s'lodhem si mund të lodhet era  
Dhe s'pushoj si mund të pushojë shiu.  
Diku përjetësisht shkoj —  
drejt teje.  
Të dua.

\* \* \*

I urti gjysh, i rrepti gjysh!  
Në jetë pa u hedhur mirë  
Sa gjëra më mësove: Qysh  
Të njoh unë barërat erëdlirë,

Të ndiej forcën e natyrës,  
Kur bën shtërngatë e vërtetë;  
Të gjej në thellësi të këngës  
Atë që më thërret në jetë,

Të gjej në popull frymëzimin  
Dhe t'i këndoje pavdekësinë;  
Të jem i thjeshtë si flok dëbore  
Që lind, dhe një me shokët shkrin.

I urti gjysh, i miri gjysh,  
Më le ti fjalën të rreptë-zjarr,  
Më le ti ngrohtësinë e fjalës  
Dhe karakterin shqipëtar.



## QILIMI

Sa ëndërra janë derdhur mbi ty,  
Qilim i thjeshtë,  
I dashur shumë.  
Me duart e shkathta gjyshja ime  
Kaq net ka gdhirë për ty pa gjumë.  
Tek ti ajo veshi vajzërinë,  
Që vrapoi pas një qerreje mbi baltë,  
Kur ca krushq të panjohur erdhën  
Dhe shkelën mbi ëndërrat e saj  
Sikur të shkelnin mbi kashtë.

Vezullojnë mbi ty shkëlqimet e yjve,  
Ngjyrat e ylberit janë skalitur.  
Shpatullat e maleve  
Mbi ty sikur janë ngritur.

Fushat me barin e butë të porsambirë  
Kaq hollë në fijet e tua ka derdhur.

Nga ti, qilim, del një aromë erëmirë  
Sikur lulet e tërë dheut sipër të kanë hedhur.

Vallen e të lashtave sikur sheh  
Kur grunjërat janë pjekur,  
Thekët e tua bien si drapëri  
Në arën  
Që korrjen e mbarë pret e etur.

Gjyshja një pushkë ka endur mbi ty,  
Pushka është shkrehur,  
Dhe flaka po shndrit, —  
Ja, kjo është ëndërra e gjyshes, e popullit:  
Luftë për liri,  
Për jetë,  
Për dritë.

Vijëza të gjata  
                        si ngastrat e arave  
Tej e përtej radhë-radhë të përshkojnë,  
Ja, këto janë të mbjellat e bollshme,  
Bisqet e rinj që mbijnë para nesh  
Dhe ti,  
I thjeshti, i dashur qilim  
Mbas valles së thekëve përjetësisht buzëqesh!

\* \* \*

Ky rrap shekullor mes drurësh të tjerë  
Ngjan si luftëtar i kthyer nga beteja —  
Krenar por i thjeshtë.

Lulet përreth  
Mbijnë dhe në valle e venë në mes.

Kohërat me vitet e rrapit janë matur.  
Është kalbur e vjetra,  
E reja ka ardhur.  
Vallen e re do ta çojë gjer në fund  
Prijsi krenar, por i thjeshtë, në katund.

1. The first part of the report is devoted to a general  
description of the project and its objectives.  
2. The second part contains a detailed description of the  
methodology used in the study.  
3. The third part presents the results of the study and  
discusses their implications.

4. The fourth part discusses the conclusions of the study  
and offers suggestions for further research.  
5. The fifth part contains a list of references.  
6. The sixth part contains an appendix with additional  
information.



## PASQYRA E LËNDES

Moshatarëve. ....	3
Kënga ime .....	4
E di unë .....	6
Shtyllat elektrike .....	7
Kufitari natën e vitit të ri .....	8
Vargje për miqësinë punëtore .....	9
Naftëtarët në dhomën e ngrohjes pas punës .....	11
Kur buzëqeshin shokët .....	12
Këngë për shokët e mi naftëtarë .....	13
Mikroborgjezit. ....	17
Kontroll punëtor .....	19
Vërtetësia. ....	20
Marshimi i revolucionit .....	22
Mjeshtri plak .....	24
Flakja e ikonës në oborrin e vjetër .....	26
Lajmësit. ....	29
Unë eci .....	30
Partizani. ....	32
Flakët ndezën natën... ..	35
Poezia. ....	37
Thirrme, do të të vij, i lehtë si zog .....	38
Vargjet. ....	39
Një imitonjësi. ....	40
Vjeshta e artë .....	41

Poezia e De Radës .....	42
Zemra e lirikut .....	44
Pritja .....	46
Të dua .....	47
I urti gjysh, i rrepti gjysh! .....	48
Qilimi .....	49
Ky rrap shekullor mes drurësh të tjerë .....	51

7-28 N

MIHAL DURI  
STABILIMENTI

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

---

Shtyp NISH shtypshkronjave «MIHAL DURI»  
Stabilimenti «8 NËNDORI» — Tiranë, 1969